

**UNIVERSITETI MJEKËSISË TIRANË  
FAKULTETI I SHKENCAVE MJKËSORE TEKNIKE  
DEPARTAMENTI I DIAGNOSTIKËS DHE REHABILITIMIT  
SHËNDETËSOR**

**ROLI I MAMOGRAFISË NË  
DIAGNOSTIKIMIN MIKROKALÇIFIKIMEVE  
TË GJIRIT**

**Disertacion  
Për Marrjen e Gradës Shkencore**

**DOKTOR**

**Disertanti: Agim Dokaj  
Udhëheqës Shkencor: Prof. Dr. Tahir Hysa**

**TIRANË 2015**

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I MJEKËSISË TIRANË  
FAKULTETI SHKENCAVE MJEKËSORE TEKNIKE**

**DISERTACION  
I PARAQITUR NGA  
Z. AGIM DOKAJ  
PËR MARRJEN E GRADËS SHKENCORE**

**DOKTOR**

**SPECIALITETI: IMAZHERI**

**TEMA: “ROLI I MAMOGRAFISË NË DIAGNOSTIKIMIN  
E MIKROKALÇIFIKIMEVE TË GJIRIT”**

**MBROHET NË DATË: ...../.....2015. PARA JURISË:**

1. .... KRYETAR
2. .... ANËTAR (OPONENT)
3. .... ANËTAR (OPONENT)
4. .... ANËTAR
5. .... ANËTAR

## ***Parathënie***

*Mamografia depistuese kontribuon në përmirësimin e mbijetesës nga kanceri i gjirit përmes zbulimit dhe trajtimit të hershëm të lezioneve jo të palpueshme.*

*Për këtë arsye edhe nga Ministria e Shëndetësisë po kryhen depistime në të gjithë vendin tek femrat e moshës mbi 40 vjeç.*

*Shpresojmë që studimi ynë do të kontribuojë në evidentimin e faktorëve të riskut të patologjive malinje të gjirit në qarkun e Shkodrës dhe të ndihmojë në hartimin e politikave parandaluese të këtyre faktorëve.*

## **Falënderim**

Falënderoj udhëheqësin tim shkencor Prof. Dr. Tahir Hysa për ndihmën në të gjitha etapat e studimit duke më ofruar eksperiencën e tij të gjatë në fushën e Radiologjisë.

Falënderoj koleget e mi në Spitalin Rajonal Shkodër për bashkëpunimin e ngushtë dhe përkrahjen e tyre.

Falënderoj familjen time për mbështetjen dhe kurajon për të përfunduar me sukses këtë projekt shkencor.

## **Shkurtesa**

BI-RADS                      Breast Imaging Reporting and Database System

BMI                            Body Mass Index

OBSH                         Organizata Boterore e Shendetesise

ROC                          Receiver Operator Characteristic Curve

AUC                          Area Under Curve

## **Përmbajtja**

<i>Parathënie</i> .....	3
Falënderim .....	4
Shkurtesa.....	5
Abstrakt .....	7
<b>I HYRJE</b> .....	10
1.1 Anatomia Radiologjike .....	10
1.2 Kalçifikimet mammarë beninje dhe malinje .....	13
1.3 Diagnoza.....	14
1.3.1 Përkufizimi.....	14
1.4 Fizpatologjia .....	14
1.5 Kriteret e klasifikimit .....	16
1.6 Studimi i Mamografisë dhe interpretimi i kalçifikimeve : .....	16
1.7 Format e kalçifikimeve dh shpërndarja e kalçifikimeve .....	17
1.8 Strategjia diagnostikuese.....	25
1.9 Mammografia: Semiotika.....	25
1.10 Shenjat mamografike mund të ndahet në: .....	26
1.11 Mamotome.....	28
1.12 Teknika dhe metodologjia .....	29
1.13 Indikacione .....	32
1.14 Përgatitja dhe leximi mikrohistologjik .....	32
1.15 Vëzhgimet.....	33
<b>II METODOLOGJIA</b> .....	36
2.1 Qëllimi.....	36
2.2 Objektivat .....	36
2.3 Materiali dhe Metoda .....	36
2.4 Metodologjia e analizës statistikore.....	37
<b>III REZULTATET</b> .....	40
<b>IV DISKUTIM</b> .....	67
<b>V PËRFUNDIME</b> .....	67
<b>VI REKOMANDIME</b> .....	77
<b>VII BIBLIOGRAFIA</b> .....	78

## Lista e tabelave

Tabela 3. 1 Karakteristikat socio-demografike të grave në studim. (N=1500).....	40
Tabela 3. 2 Karakteristikat e popullatës në studim .....	43
Tabela 3. 3 Densiteti mamografik për totalin e grave .....	45
Tabela 3. 4 Karakteristikat e grave me mikrokalçifikime (n=30).....	47
Tabela 3. 5 Karakteristikat e mikrokalçifikimeve (n=30) .....	49
Tabela 3. 6 Shpërndarja e kalçifikimeve tek pacientët.....	52
Tabela 3. 7 Karakteristikat e mikrokalçifikimeve të grupuara: beninje dhe malinje .....	55
Tabela 3. 8 Sistemi BI-RADS sipas modelit të densitetit të gjirit për rastet malinje .....	58
Tabela 3. 9 Klasifikimi i lezioneve beninje .....	59
Tabela 3. 10 Klasifikimi i lezioneve malinje .....	61
Tabela 3. 11 Krahasimi i kurbave ROC .....	63
Tabela 3. 12 Krahasimi “Pairwise” i kurbave ROC.....	64
Tabela 3. 13 Krahasimi i kurbave ROC të Mamografisë dhe Echo.....	66
Tabela 3. 14 Krahasimi i sensitivitetit, specificitetit dhe vlerës parashikuese .....	66

## Lista e figurave

Figura 3. 1 Shpërndarja e pacientëve grupmoshës.....	41
Figura 3. 2 Shpërndarja e grave sipas vendbanimit .....	41
Figura 3. 3 Shpërndarja e rasteve sipas nivelit arsimor.....	42
Figura 3. 4 Shpërndarja e rasteve sipas gjendjes ekonomike .....	42
Figura 3. 5 Karakteristikat e popullatës në studim.....	44
Figura 3. 6 BMI e pjesëmarrësëve sipas moshës .....	45
Figura 3. 7 Densiteti mamografik për totalin e grave.....	46
Figura 3. 8 Karakteristikat e grave me mikrokalçifikime (n=30) .....	48
Figura 3. 9 Frekuenca e hasjes së mikrokalçifikimeve sipas gjirit .....	50
Figura 3. 10 Nr. of mikrokalçifikimeve/cm <sup>2</sup> .....	50
Figura 3. 11 Lokalizimi .....	51
Figura 3. 12 Shpërndarja e mikrokalçifikimeve.....	51
Figura 3. 13 Shpërndarja e kalçifikimeve tek pacientët .....	52
Figura 3. 14 Morfologjia .....	53
Figura 3. 15 Densiteti mesatar .....	53
Figura 3. 16 Frekuenca e mikrokalçifikimeve malinje.....	54
Figura 3. 16 Karakteristikat e mikrokalçifikimeve të grupuara.....	56
Figura 3. 17 Sistemi BI-RADS sipas modelit të densitetit të gjirit për rastet malinje .....	58
Figura 3. 18 Lloji i ekzaminimit histopatologjik .....	59
Figura 3. 19 Klasifikimi i lezioneve beninje.....	60
Figura 3. 20 Klasifikimi i lezioneve malinje .....	61
Figura 3. 21 Krahasimi i kurbave ROC të mjekëve Radiologë dhe Kirurgut.....	62
Figura 3. 22 Krahasimi i kurbave ROC të mjekëve Radiologë dhe Kirurgut dhe si Grup 63	
Figura 3. 23 Krahasimi i kurbave ROC të Mamografisë dhe Echo .....	65



## Abstrakt

**Hyrje:** Mamografia depistuese kontribuon në përmirësimin e mbijetesës nga kanceri i gjirit përmes zbulimit dhe trajtimit të hershëm të lezioneve jo të palpueshme.

**Qëllimi i studimit:** Vlerësimi i roli të mamografisë në diagnostikimin e mikrokalçifikimeve të gjirit.

**Materiali dhe metoda:** Në studim janë përfshirë 1500 gra të moshës 45-55 vjeç në qarkun e Shkodrës të cilat kanë kryer ekzaminimin e mamografisë në kuadër të një programi depistimi gjatë vitit në Spitalin Rajonal Shkodër në periudhën 2010-2013.

**Rezultate:** Shumica e pjesëmarrëseve (68%) e tyre banojnë në zonën urbane, 97% e tyre janë të martuara. Mikrokalçifikime janë zbuluar në 2% 95%CI (1.4 – 2.84) të grave. Moshë mesatare e grave me mikrokalçifikime është 47.2 (1.9) vjeç; Të gjitha keto gra kanë fëmijë: 57% e tyre kanë 2 fëmijë. Vetëm 6% e grave nuk kanë kryer abort; 50% e tyre kanë kryer 2 aborte; Vërehet nivel i lartë i përdorimit të kontraktivëve, mastopative të përsëritura dhe historisë familjare për Ca tek gratë me mikrokalçifikime. 87% e grave kishin mikrokalçifikime të grumbulluara; 69% e mikrokalçifikimeve të grupuara janë paraqitur si një grup i vetëm; Mbizotërojnë forma amorfe (23%) dhe heterogjene (50%); Në 67% të mikrokalçifikimeve densiteti mesatar është i ulët; Në 31% të mikrokalçifikimeve të grupuara është zbuluar formë malinje ndërsa në (69%) formë beninje; Nga analizave e kurbave ROC nuk vërehet ndryshim ndërmjet sipërfaqes në kurbë ndërmjet autorit krahasuar me kolegun radiolog dhe kirurgun dhe si grup specialistësh.

**Përfundim:** Mikrokalçifikimet e grumbulluara mund të jenë i vetmi manifestim i dallueshëm i kancerit të hershëm të gjirit. Vlerësimi mamografik i kalçifikimeve është një pjesë thelbësore e vlerësimit të programit të depistimit. Studimi thekson efektivitetin e programit të depistimit në diagnostikimin e mikrokalçifikimeve dhe malinjitetit të gjirit tek gratë.

**Fjalë kyçe:** mamografi, gjiri, mikrokalçifikim, depistim

# I HYRJE

## 1.1 Anatomia Radiologjike

Njohja e anatomisë radiologjike të gjirit normal është thelbësore për një interpretim të saktë dhe për një qasje të drejtë për studimin e patologjisë së këtij organi. Ky koncept është në vetvete themelor për studimin e çdo organi, është edhe më shumë për gjirin në raport me ndryshueshmërinë anatomike dhe funksionale që e karakterizon. Në fakt është e pamundur të përcaktojmë një imazh të vetëm radiologjik të gjirit normal, pasojë kjo e thithjes së rrezatimeve nga komponentet e ndryshme anatomike dhe e raporteve të tyre sasiore dhe hapsinore.

Elementet përbërëse të imazhit të mamografisë janë indi lidhës, indi dhjamor dhe një pjesë e vogël e epitelit galactophore (qumështsjellës). Nga e para varet densiteti i gjirit, nga e dyta varet radiotrasparenca dhe nga të dyja së bashku varet dendësia e përgjithshme e rrezatimit morfologjik të organit (1).

Një element thelbësor është uji, i cili ka sasi të ndryshueshme në lidhje me ndikimin e stimujve hormonal. Ai është përgjegjës i dendësisë më të madhe apo më të vogël. Kjo errësirë fiziologjike e fizpatologjike është në fakt e varur nga estrogeni.

Kështu përdorimi optimal i teknikës së ekzaminimit në raport me tipologjitë e ndryshme të organit është thelbësor për një cilësi të mirë të imazhit.

### Figura 1

Gjatë mamografisë, mund të njohim strukturat anatomike normale të gjirit:

- Lëkura
- Kompleksi Areola- thithi i gjirit
- Indi dhjamor
- Corpus mammae (gjinjtë)
- Muskuli pectoral
- Enët e gjakut

- Lëkura

Veshja e lëkurës vërehet si një strijë e hollë radiopake me trashësi gati 1 mm e dukshme qartë përmes radio-transparences së yndyrë premammare.

- Kompleksi Areola- thithi i gjirit

Në korrespondencë me kompleksin areola- thithi i gjirit konstatohet një trashësi prej pothuajse 3-5 mm të rrjetës radiopake të lëkurës; para së gjithash kufijtë e thithit të gjirit caktohen si një kon me madhësi të ndryshueshme, në përgjithësi pak të dukshme në mammografinë standart.

- Kanalet

Kanalet normalisht nuk janë të dukshme në mammografi por mund të njihen si formacione shiritash të shumëfishtë pak radiopake (të patejdukshëm), me kalibër dhe gjatësi variabël, paralele dhe me një dekurs radial divergjent (largues) në thellësi.

- Indi dhjamor

Indi dhjamor që shfaqet radiotransparent, mbulon paraprakisht dhe prapa gjinjtë të përfaqësuar në sasi të ndryshueshme. Paraprakisht shfaqet si një laminë (fletë) radiotransparente që përshkohet nga stria radiopake të holla të quajtura kreshtat e Duret dhe ligamentet e Cooper. Prapa është e dukshme qartë hapësira postmaterne që ndan gjirin nga fasha muskulare e gjoksit (qesja e Chassignac) duke lejuar një shkallë të caktuar lëvizshmërie të mamelës.

- Corpus mammae (gjiri)

Gjiri është i përfaqësuar nga matrica adeno- fibro- adipose e cila formon një trung në formën e konit me bazë torakale dhe me kulm drejtuar nga thithi i gjirit. Ndodhet midis shtresës fibroze sipërfaqësore dhe asaj të thellë (2).

Patejdukshmëria e ndryshme e gjirit është funksionale në dy parametra:

- përpjestime të ndryshme sasiore dhe vendosja hapsinore e indeve të individit
- hidratim i ndryshëm i indit lidhës në raport me stimujt hormonal

Nuk ekziston një aspekt unik i mamelës normale, por ekziston një sensibilitet individual i stimujve hormonal nga ku varet evolucioni i raporteve mes përbërësve të ndryshëm, pra aspekti i gjirit më shumë apo më pak i dendur. Kjo do të thotë që tashmë është vjetëruar koncepti i ngurtë i raportit mes dendësisë së gjirit dhe moshës së pacientes.

Gjithashtu, asnjë marrëdhënie nuk mund të përcaktohet në kuptimin patogjen apo semiologjik mes dizomogjenitetit dhe dendësisë mamografike të gjirit dhe prezencës së displazisë apo mastopatisë fibrocistike. Këto terma që shkaktojnë një konfuzion në planin klinik dhe diagnosikues, konsiderohen tashmë të vjetëruara si dhe të pa sakta.


Aspekti mamografik i fotove të ndryshme morfologjike të mamelës normale, është funksioni i variacioneve të proceseve normale të zhvillimit të palidhura me proceset patologjike. (3,4).

Duke marrë parasysh elementet morfologjike që përbëjnë mamografinë, si patejdukshmëria e radiotrasparenca dhe shpërndarja e tyre cilësore e sasiore, më 1986 është propozuar një karakterizim radiologjik në mënyrë që të jemi në gjendje të vlerësojmë variabilitetin e llojeve të ndryshme të strukturës mamare.

Kështu rezultoi një klasifikim prej 6 strukturave, që përfshin kuadret radiologjike më e zakonshme:

1. Struktura fibroadipoze paraqet një përbërës të madh yndyre (dhjamë), që vjen si pasojë e mungesës totale të parenkimës, tepron vetëm një rrjet i butë. Kjo strukturë është e karakterizuar nga një radiotrasparencë e përhapur.
2. Struktura fibrogiandolare haset shpesh. Ajo është e karakterizuar nga përzjerja e strukturës dhjamore dhe nga komponenti lidhës- epithelial, me një prani më të madhe të toneve radiopake. Përcaktimet hapësinore paraqesin formën ideale trekëndore të corpus mammae (gjinjëve).
- 3- 4. Strukturat mikronodulare dhe parvinodulare përcaktojnë shpërndarjen e veçantë të komponentit të bollshëm parenkimal që është i konfiguruar (i përhapur) me masa nodulare të përzier me yndyrë, të diametrave të ndryshme pothuajse deri në 3 mm në stukturën mikronodulare dhe deri në 6-7 mm në strukturën parvinodulare.
5. Stuktura e çrregullt nodulare paraqet një komponent yndyror shumë të varfër. Komponenti fibrogianolar ka aspekt jo homogjen, me pllaka të madhësive të ndryshme duke i dhënë origjinë dhe një pamje të çrregullt.
6. Struktura e dendur është e karakterizuar nga mungesa totale e indit dhjamor, parenkima duket si një bllok homogjen intensivisht radiopak (jo i tejdukshëm) që pengon leximin e radiografisë.

### Anatomia e gjirit



#### -Muskuli pektoral

Është i përfaqësuar (i përbërë) nga një patejdukshmëri homogjene e pozicionuar para murit të kraharonit, me formë trekëndore, ku kulmi inferior i tij është në projeksionin: medio-laterale e oblike dhe cranio- kaudale. Kjo e fundit merr një konfiguracion “gjysëmshënë” e dukshme në mënyrë variabël në raport me konfiguracionin anatomik të thoraxit dhe me mënyrën korrekte të kryerjes së grafisë (pozicionimi). (5,6).

Në përgjithësi kufiri i poshtëm i patejdukshmërisë së muskulit pectoral duhet të qëndrojnë në projeksionin oblik mbi një aks ideal që prapa arrin deri në thithin e gjirit.

- Enët e gjakut

Enët e gjakut janë janë të dukshme qartë tek gjinjtë të pasur me përbërës yndyrorë, si shirita të hollë dhe delikat, me dekurs pak a shumë të tërthortë, ndonjëherë edhe me parete të kalçifikuara (imazhet në formë “udhe”).

- Variante

Pranë imazheve radiologjike “normale” që u përshkruan lart, duhet të kujtojmë se në disa raste mund të vërejmë disa “variante” të tjera krejtësisht normale gjithashtu, që mund të përcaktohen fiziologjike dhe anatomike.

Variantet fiziologjike janë vërejtur kur ka një rritje të mbufatjes të indit, të gjëndrrave: puberteti, faza premenstruale, shtazania, ushqyerja me gji janë të karakterizuara nga një rritje e radiopacita (patejdukshmërisë) së parenkimës.

Herë pas here mund të hasen disa variante anatomike të përbëra nga:

- Nyjet limfatike intra-mammare: radiopacita të vogla me sipërfaqe të rrumbullakosur, radiotrasparente margjinale (anësore).

- Ind ektopik: patejdukshmëri (errësirë) jo homogjene e vendosur përgjatë bazës axillare, tregues i indit të gjëndrrave (ghilandolare) në kuadër jo të rregullt.

- Relaksimi i bazës (shtyllës) axillare: i dukshëm shpesh tek gratë e moshuara dhe obeze. (7).

- Ectasia ductale: theksohet prapa areolës nga prania e formacioneve në formë rrjete, shiritash të dobta (radiopache) me kalibër variabël.

## 1.2 Kalçifikimet mammarë beninje dhe malinje

Duke marrë hua një përkufizim që dikush në të shkuarën ka përdorur duke trajtuar këtë argument, mund të themi: “Kalcifikimet mammarë: një bekim, një mallkim!”

Në këtë thënie të shkurtë, përfshiet gjithë kompleksiteti i studimit të këtyre masave semjotike, që në pamje të parë duken të thjeshta por shpesh janë ambigue. Mammografia dhe risitë e vazhdueshme teknologjike kundrejt saj, kanë lejuar me kalimin e kohës një përceptim më të lehtë të këtyre shenjave, që shpesh janë në limit të dukshmërisë, por sigurisht ia kanë bërë më të vështirë punën radiologut për ta interpretuar.

Që nga puna e hershme e Raul Leborgne më 1949 e deri në ditët tona, një numër i madh studimesh janë publikuar në lidhje me piritshmërinë e shenjave mamografike në kalçifikime dhe me kalimin e kohës janë arritur bindje shpesh kontradiktore mes tyre, të cilat në mënyrë simbolike janë risjellë në konkluzion të dy studimeve të të njëjtit autor, Egan. Më 1969 ai shkroi: “Prania e kalçifikimeve tipike është aq patogmonica sesa një

histologji beninje nënkupton një gabim të kirurgut ose të patologut ” por po ai pas një viti e mbyll studimin tjetër me frazën: “Shenjat radiologjike janë shumë pak të specifikuara, si pasojë të gjitha kalçifikimet duhet të operohen ”.

Kjo thënie në kohët e hershme kryesisht në Amerikë, ka qënë shkaku për një numër të lartë kërkesash për biopsi të padobishme por, fatmirësisht në vitet e fundit vëmë re një inversion (përmbysje) të tendencës (8,9).

Kjo hyrje e shkurtë ka si qëllim prezantimin e argumentit që do të trajtoj si një kapitull jo të lehtë për t’iu qasur dhe mbi të cilin peshojnë edhe sot shumë dyshime dhe konfuzione. Në mënyrë të shkurtuar do të trajtoj:

- Përkufizimi
- Fispatologjia
- Kriteret e klasifikimit

### **1.3 Diagnoza**

#### **1.3.1 Përkufizimi**

Kalçifikimet janë masa të patejdukshme me densitet, formë dhe madhësi të ndryshueshme. Shprehje e proceseve, sekretore ose degjenerativ të indeve të gjirit të shkaktuara nga depozitimi i kripës dhe i kalçiumit.

#### **1.4 Fizpatologjia**

Proçesi i kalçifikimit të indeve mund të jetë i lidhur me fenomene fiziologjike ose patologjike. Një njohje më e mirë e mekanizmave thelbësore të kalçifikimit mund të kontribuojë për një analizë më rigorozë dhe më kritike të imazheve të njëjta radiologjike. Trupi i një njeriu adult (të rritur) përmban pothuajse 1000 gr. kalçiumi, prej të cilave 990 gr. janë në skelet, 9 gr. janë në inde (jo të mineralizuar) dhe 1 gr. ndodhet në likidet jashtëqelizore. Përbërja fiziko-kimike e kalçifikimeve mamare është vënë re prej disa vitesh (Hassler 1969, Ahmed 1975, Barth 1977, Busing 1981, Frappart 1984-1986).

Studimet e kohëve të fundit e pikërisht ai i Frappart, ka studiuar dy tipet e kalçifikimeve në funksion të strukturës së tyre dhe përbërjes kimike, nëpërmjet metodave të ndryshme (spektroskop, mikroskop elektronik):

Tipi 1 (Oxalatet e kalçiumit) përbëjnë 10 % të kalçifikimeve. Quhen edhe Weddeliti për nga struktura e njëjtë me një kristal të zbuluar në detin Weddel. Këto mund të kalojnë pa u shikuar në mikroskop me HES. Ato i korrespondojnë oxalateve të kalçiumit Dihydrate ( $\text{CaC}_2\text{O}_4 \cdot 2\text{H}_2\text{O}$ ). Këto kristale formohen gradualisht në produktin e sekretimit që akumulohet në gjëndra gjatë mastopative kronike. Për pjesën më të madhe të autorëve janë të lidhura me patologji beninje (10,11).

Tipi 2 (Fosfati i Ca idrossiapatite) përbën pothuajse 90 % të kalçifikimeve. Struktura e tyre nuk është kristalinë dhe forma varet nga origjina sekretore ose nekrotike. Mund të

lidhen me patologji beninje ose malinje. Në palologjinë sekretore manifestohet me perla të vogla me madhësi variabël (të ndryshueshme). Lokalizohen kryesisht në lobe dhe kanë një formë të rumbullakët. Ato me origjinë nekrotike ndodhen në duktuse (kanalet) e qumështit. Mes klasifikimeve patologjike duhet të dallojmë ato metastazike nga ato distrofike. Të parat i interesojnë mamelës rrallë herë dhe janë të lidhura me kushtet e hiperkalçemisë. Të tjerat zhvillohen në një ind të dëmtuar, pa pasur alterime (ndryshime) të kalçemisë edhe fosforit. Më së shumti vihen re ndryshime të indeve që ndodhin për shkak të nekrozave të origjinave të ndryshme (koagulime gjaku, shpërbërje e indeve, liponekroza). Në karcinomën e gjirit, ka faktorë të tjerë që favorizojnë procesin e kalçifikimit:

- predispozita e disa qelizave për të mbledhur kalçiumin
- pasuria me ATP e membranave citoplazmatike të qelizave tumorale
- pH acid brënda tumorit

Shumë studime janë sjellë në literaturë mbi mineralizimin e indeve të gjirit. Për Baldet formimi i kalçifikimeve mamare (të gjirit) bëhet sipas modelit të mineralizimit të kockave dhe është e lidhur me:

- një fazë organike (fibrave të kolagjenit tip 1, proteina të kolagjenit)
- një fazë minerale të kockave (fosfati i Ca)

Në origjinën e kalçifikimeve ka fenomene sekretimi ose alterimi të qelizave duke qënë se janë të lidhura me procese inflamatore, degjenerative, metabolike ose traumatike. Duke ndjekur modelin e tij teorik të formimit të kalçifikimeve, mund të vërehet sesi kalçiumi është përfaqësuar ndryshe dhe është shprehje e fazave të ndryshme patologjike sipas interesimit ndarjeve (sektorëve) të ndryshme të gjëndrës së gjirit (12,13).

1. Stadi normal, kalçiumin e gjejmë në formë të tretshme në sekretim
2. Kalçifikimi i sektorit të jashtëm (të duktusit galatofor, qumështsjellës) në lidhje me patologjitë e sekretimit:
  - a) staza dhe anomali sekretore
  - b) cisti
- 3) Kalçifikime të epitelit të ndërfaqes. Patologjia degjenerative dhe nekroza e qelizave.
  - a) degjenerim i qelizave
  - b) hiperplazia epiteliale beninje
  - c) tumoret malinje
- 4) Kalçifikime të sektorit të brendshëm (indi lidhës dhe indi dhjamar)
  - a) fibroza e çdo etiologjie
  - b) reagimi desmoplastik i indit lidhës për carcinoma
  - c) alterime patologjike të membranës bazale

Atëherë ne mund të konfirmojmë që kalçifikimet janë gjithmonë shprehje të një patologjie të kombinuar. Ato siç thotë Baldet përbëjnë një lezion të vetëm natyrën e tyre.

## 1.5 Kriteret e klasifikimit

Pas kësaj reference për proceset fiziopatologjike të formimit të kalçifikimeve, kalojmë në studimin e tyre. Të gjithë e dime që Mammografia ende mban rolin për metodën “mbretëshë” në studimin e lezioneve infraklinike të gjirit, aq shumë sa që ka qenë përdorur si metodë depistimit për shkak të vlerës së lartë të sensitivitetit dhe specificitetit treguar nga kjo. Kalçifikimet përbëjnë një nga shenjat mammografike më të zakonshme dhe të vështira për tu lokalizuar dhe interpretuar; dallimi mes tyre bëhet në lidhje me madhësinë e tyre:

- kalçifikime të trasha
- mikrokalçifikime

Disa kalçifikime sipas autorëve të ndryshëm kanë një diametër më të vogël se 1 mm., sipas disa të tjerëve më të vogël se 0.5 mm, duke i dhënë këtyre të fundit gjithnjë e më shpesh një një konotacion malinj.

Kjo diferencë në realitet nuk është korrekte sepse ajo ka të bëjë vetëm me madhësinë e njësive individuale dhe jo me natyrën e tyre, motiv për të cilin dikush sugjeroi që të mos përdorin termin mikrokalçifikime, por vetëm atë të përgjithshëm të kalçifikimeve që mund të jenë beninje të dyshuara ose malinje. (14,15).

Kufiri i dukshmërisë radiologjike të kalçifikimeve ka një vlerë pothuajse prej 100 $\mu$ , sigurisht me diametër më të vogël në krahasim me ato të matura në seksionet histologjike, që shfaqen në mënyrë të konsiderueshme më të vogla duke pasur një diametër prej 5-10  $\mu$  (Azzopardi). Kjo ndodh në sajë të pamjaftueshmërisë së volumit të tyre, por edhe për faktin që shpesh një grimcë e vetme e vënë re nëpërmjet Mamografisë, duket të jetë përmbledhje e më shumë grimcave.

## 1.6 Studimi i Mamografisë dhe interpretimi i kalçifikimeve kalon në disa faza të detyrueshme:

### 1. Kontrolli i cilësisë së imazhit.

Në mënyrë që të perceptojmë ndryshimet e indeve është e domosdoshme të kryhet ekzaminimi në mënyrë korrekte. Pajisjet që përdoren duhet të jenë të gjeneratës së fundit, cilësia duhet të jetë absolute në lidhje me ekspozimin e saktë, pozicionimin dhe trajtimin e filmit. Duhet të sigurohemi që nuk ka objekte (artefakte) për shkak të pranisë së talkut, pluhurit etj. dhe që ekranet janë të pastra.

### 2. Përceptimi.

Gjatë leximit të mamografisë është sigurisht moment që sjell shumë ankth. Për një vlerësim të saktë të ekzaminimit, leximi duhet të bëhet në një ambient të qetë, me ndriçimin e duhur, duke përdorur difanoscopi (kuti të lehta me dritë) me kërkesa të veçanta ndriçimi. Thelbësore është analiza sistematike krahasuese e Mamografive sepse mund të jetë e domosdoshme për një preçizim më të saktë. Ndhimesë e madhe mund të jetë krahasimi me ekzaminimet e mëparshme, veçanërisht në qoftë se ndiqet në mënyrë të



vazhdueshme, që mund të shërbejë për të konstatuar stabilitetin ose evolucionin e mundshëm të disa sëmundjeve. (16-18).

### 3. Analizat.

#### 1.7 Format e kalçifikimeve dhe shpërndarja e kalçifikimeve

Pasi të përceptohen kalçifikimet duhet të analizohen dhe klasifikohen si beninje, të dyshimta ose të papërcaktuara, malinje. Ato mund të dallohen në bazë të vendndodhjes së tyre në sipërfaqe ose intramammare dhe mund të shfaqen të izoluara ose shoqëruar me një patejdukshmëri, por pa dyshim parametrat semjotikë janë:

- Madhësia
- Densiteti
- Numri
- Forma
- Shpërndarja

Në lidhje me këtë janë propozuar klasifikime të ndryshme radiologjike. Nga një pikëvështrim radiologjik parametrat semiologjik më të rëndësishëm për studimin e kalçifikimeve janë sigurisht morfologjia dhe shpërndarja, nëpërmjet analizave të këtyre parametrave mund të kthehemi në vendin e ndryshimit anatomo-patologjik, pra në njohjen e vëndit anatomik (duktuse, lobe, indet mbështetëse).

Mbi këtë koncept bazohet “teoria e formës” e Lany, sipas të cilit forma e kalçifikimeve është e lidhur më strukturën anatomike në të cilën ajo shfaqet dhe prandaj dallon kalçifikimet e duktuseve dhe kalçifikimet e lobeve, sipas zhvillimit të tyre në kontekstin e duktusit dhe të lobit. (20-23).

Të parat, dukuset shfaqen të çrregullta, ndonjëherë të degëzuar, riprodhim i morfologjisë së strukturës së origjinës dhe janë ato që shoqërojnë më shpesh siç do ta shohim tek Ca. Nërsa ato lobulare kanë një formë të rrumbullakët të rregullt dhe janë shpesh të lidhura me prezencën e patologjisë beninje. Lany në punën e tij, thekson rëndësinë e formës e shpërthimit si element i rëndësishëm; prandaj kalçifikimet e grupuara ndikojnë në një zonë rrethore, bëhet fjalë më shpesh për një formë beninje, në të kundërt një dispozitë trekëndore apo trapezoide e shpërthimit ngjall dyshime malinje.

Pra, në bazë të një kriteri krejtësisht morfologjik, kuptojmë që janë propozuar të tjera kalçifikime radiologjike nga Le Gal më 1976 dhe pastaj më 1984 bënte dallimin mes pesë tipeve të kalçifikimeve me një vlerë parashikuese malinje në rritje (24,25).

Puna e Tabar për klasifikimin e kalçifikimeve mammare mbetet pa dyshim njeri prej më të mirave të literaturës mondiale. Edhe ai përdor një kriter morfologjik duke bërë dallimin mes relacioneve të origjinës së kalçifikimeve të duktuseve e lobulare dhe të të dyjave së bashku duke përcaktuar parametrat të tjerë shtesë të cilat janë: forma që mund të jetë

- duttale grandulare

- duttale e masës
- lobulare që lindin nga një zgavër sferike që përcakton formën e tyre.

Kur kalçifikohen totalisht formohen grimca sferike në formën e margaritari (perle). Në hiperplazinë cistike kur dilatacioni i lobeve formon zgavra sferike mjaft të mëdha, likidi cistik mund të përmbajë grimca që lëvizin lirisht si “kalciumi i qumështit”, që depozitohet në një apo më shumë proporcione të kavitetit dhe janë të dukshme më së shumti në pozicion lateral. Kalçifikime të tjera lobulare janë në formën e filxhanit të çajit ose gjysmëhëne.


Densiteti: i ndryshueshëm në duktuse, ndërsa në ato lobulare kanë një dendësi të lartë.

Numri: sipas disa autorëve numri i kalçifikimeve brënda një cluster mund të jëtë indikues dhe për më shumë mendohet se në rast malinjiteti nuk ka një numër më të vogël se 5 kalçifikime për centimetër kub të indit (Egan).

Forma e kalçifikimeve:

Klasifikimi i publikuar së fundmi në studimin e American College of Radiology (BI-RADS) (ACR) dhe ReCoRM (V. Lattanzio- G. Simonetti) dallojnë këto kalçifikime:

1. Kalçifikime beninje suspekt (të supozuara).



### Kaçifikime duktale

- Në formën e lëvozhgës së vezës:


Kryesisht të vendosura në paretet e cisteve të vogla ose në vatrat e yndyrë së nekrozës. Shfaqen si një kokorreth i kalçifikuar prej 1 mm. që mbështjell një sferë hiperdiafane.

- Sferike dhe me qendër hiperdiafano:

Me sipërfaqe të lëmuar, të rrumbullakët ose në formë ovale; janë kryesisht sfera krejtësisht të kalçifikuara ose kalçifikime në formë unaze me shumë rrethe. Mund të jenë pasojë e liponekrozës si rrjedhojë e traumave aksidentale ose kirurgjikale, terapisë radiante ose ektazia duktale. (26,27).

□ **Vaskulare:**

Evidentohen zakonisht si një ose dy linja të kalçifikuara përgjatë pareteve vazale që determinojnë imazhe tipike të ndjekur. Zakonisht të tilla kalçifikime nuk paraqesin probleme interpretative, përveç rastit në të cilin kalçifikimi është fillestar dhe mund të paraqitet linear.



**Kalçifikime lobulare**

□ **Në shufra të mëdha (tubulare)**

Mund të mbushin ose të rrethojnë duktuse të dilatuara dhe paraqiten si segmente të vogla me konture të lëmuara kur ndodhen brenda lumenit të duktusit ose si shufra tela të

vendosura në parete. Këto kalçifikime shfaqin një dekurs tipik radial me pikënisje në regjionin retro-areolar sepse ndjekin drejtimin e duktusit dhe biforkacioni e tyre. Shfaqen më të rregullta, më të gjata, më të trasha sesa ato tipiket c. “a stampo” të tipit malinj. Janë për shkak të sëmundjes sekretuese, të mastitit plazmo -qelizor si rezultat i gjakrrjedhje së materialit lipoproteinik, irrituese në ndarjen periductale përmes pareteve të duksusit.

Në formë pulle ose shënje:

Janë kalçifikime të trasha, me densitet të rritur, me formë të ndryshueshme dhe madhësi që mund të zënë edhe krejtësisht sipërfaqen e dëmtim. Këto janë për shkak të proceseve evolutive të sëmundjeve beninje si fibroadenoma ose papilloma.

Distrofike:

Ato përfaqësojnë rezultatin e terapisë kirurgjikale dhe/ose rrezatues, janë shpesh të trasha dhe të çrregullta, jo homogjene, të shëndritshme. Edhe ato në fazat e formimit para se të marrin aspektin tipik, mund të jetë e vështirë për të bërë diagnozën diferenciale me kalçifikimet beninje. Në këto raste përdorimi i teknikës së Mammografisë në zmadhim direkt dhe një follow-up (ndjekje) për gjashtë muaj mund të jetë e dobishme.

A latte di calico:

Janë shprehje e kalçiumit të sedimentuar në një pjesë të cistës. Ky fenomen është i vërejtur më shpesh në prezencën e mikrocisteve që përfaqësojnë një epifenomen në evolucionin e vonuar të adenomës microcistike. Ato kanë aspekt menisku ose filxhan çaji në qoftë se i shohim në drejtimin ML ose MLO, ndërsa në drejtimin CC shfaqen të rrumbullakosura. Janë shpesh bilaterale dhe të shpërndara (28-30)..

Lëkurë

Shpesh e shfaqen si sfera të vogla të kalçifikuara prej 1 ose 2 mm, nganjëherë si kalçifikime në formë unaze që riprodhojnë qafën e gjëndrës dhjamore prej së cilën kanë origjinën. Vendi i tyre më i shpeshtë është regjioni peri-areolar, axilliar dhe medial. Në radiogramë vetëm disa prej tyre shfaqen në mënyrë tangente në lidhje me lëkurën prandaj shpesh duket se kanë qendër intramammare, në rast të tillë kur ekziston dyshimi, atëherë duhet të përdorim proiezione mammografike të vëzhguara në drejtim tangent me lëkurën.

Trupa të huaj

Janë të lidhura me prezencën e kalçiumit të depozituar mbi materialin qepës.

Pseudokalçifikime

Në këtë grup janë të përfshira artefaktet për shkak të: përdorimit të deodoranteve me bazë alumini në zonën axilliare, të pluhurit (pudër) talk shpesh prezente në brazdën nënammare, shkëputjes së grimcave të emulsionit nga filmi si rezultat i tërheqjes së saj nga ruli ose nga prezenca e grimcave të pluhurit mbi ekran.

## 2. Kalçifikime të dyshuara

Këtu përfshihen të gjitha ato kalçifikime që nuk shfaqin qartë shenjat semjotike beninje ose malinje. Më të shpeshta janë ato kalçifikime jokristalore ose të paqarta tepër të vogla

ose të buta për tu dalluar me qartësi. Përmirësimi progresiv i teknikës së Mammografisë sigurisht na lejon të perceptojmë një numër më të madh mikrokalçifikimesh se në të kaluarën, por kjo në kundërshtim rrit rrezikun që femra t'i nënshtrohet një numër më të madh të biopsish të panevojshme (32-34).

### 3. Kalçifikime malinje suspekt (të supozuara)


Grandulare janë të karakterizuara nga një densitet jo homogjen, me formë dhe kufinj jo të rregullt, më madhësi të ndryshueshme. Dyshimi malinj rritet më shumë kur janë të vogla (zakonisht < 0,5 cm). Morfologjia e tyre evokon pamjen e “fragmenteve prej guri”, ose “kokrra kripe”.

“A stampo”, të degëzuar janë ato kalçifikime lineare që kanë një vlerë më të lartë parashikuese për ato malinje. Aspekti i tyre linear i ndërprerë, i degëzuar sugjeron mbushjen progresive të lumenit të duktusit nga neoplazia.

#### □ Shpërndarja e kalçifikimeve.

Shpërndarja e kalçifikimeve është një tjetër parametër i domosdoshëm për të përcaktuar etiologjinë e tyre. Dallojmë katër modele:


1. Vatër infektimi ose grumbull: kalçifikimet përqëndrohen në një zonë të vogël prej < 2 cm në ind. Kjo shpërndarje nuk është në vetvete karakteristike as beninje as malinje, duke qenë në gjendje të jetë shprehje e adenozis ose heteroplazisë. Integrimi në studimin morfologjik na orienton në rrugën vendosjes së diagnozës. Sipas disa autorëve (siç ishte Egan) numri i kalçifikimeve brënda një vatre mund të jetë indikues, prandaj thuhet që në rastet malinje nuk ka një numër më të vogël se 5 kalçifikime për metër kub indi. Vatra mund të jetë e vetme ose e shumfishtë, në varësi të distancës midis njërës dhe tjetrës mund të mbështesin diagnozën multifocalita’ ose multicentricita’. (36-38).




**Shpërndarje lineare**

## 2. Segmentare:

Kalçifikimet shpërndahen në brendësi të duktuseve duke përfshirë një lob ose segment. Ato zënë një sipërfaqe më të madhe se 2-3 cm, por gjithsesi më të vogël se shpërndarja e ashtuquajtur regjionale. Kjo tip shpërndarjeje shpesh evokon praninë e një tumori të shpërndarë intraduktal, prandaj përbën një shenjë të një rëndësie të madhe.



## Mikrokalçifikime segmentare



## Mikrokalçifikime të grumbulluara

## 3. Regjionale/ e përhapur

Zënë një sipërfaqe të madhe të indeve të gjirit deri sa të jetë e shpërndarë në të gjithë mamelën. Zakonisht kjo shpërndarje është e rrallë në kancer dhe shpesh është e lidhur me proceset beninje. Bilaterali i tyre përforcon gjykimin beninj edhe pse duhet të kujtojmë që në kontekstin e kalçifikimeve të përhapura nganjëherë mund të njihen kalçifikime me morfologji të kancerit të dyshuar. (39-42).

Në këtë kapitull dua të flas edhe për Carcinomën ductale In Situ. Mikrokalçifikimet përbëjnë në fakt “shënjën kryesore” të DCIS edhe pse dihet që histologjikisht në të përfshihen një grup heterogjen karcinomash. Në rreth 80-85 % të rasteve të DCIS të diagnostikuar nga Mammografia, mikrokalçifikimet përbëjnë shënjën e vetme patologjike. Të tilla mikrokalçifikime në DCIS shfaqen të izoluara në rreth 60 % të rasteve, me aspekt të një vatre të vogël të vetme, ndërsa në format multifocali ose multicentrike mund të paraqiten me një vatër që puqen dhe në të njëjtin kuadrat dhe në kuadrate të ndryshme derisa të përfshijnë të gjithë mamelen. Në rreth 30% të rasteve mikrokalçifikimet mund të jenë të shoqëruar me një patejdukshmëri të konfiguruar. Semiotika e mikrokalçifikimeve që është tashmë e kodifikuar mire falë studimeve të autorëve të ndryshëm, na lejon në bazë të elementëve të përshkruar deri tani, të njohim parametrat thelbësor për një diagnostikim korrekt.

Nuk është i mundur asnjë korelacion që në statusin aktual të njohjes, mes gradave të ndryshme histologjike të DCIS që del nga klasifikimet më të fundit patologjike (pak, mesatarisht, e mirë diferenciuar), dhe imazhi mamografik. Duke ndjekur në mënyrë rigoroze një kriter morfologjik, disa autorë kanë përkufizuar, në fushën e DCIS, mikroklasifikimet fine, lineare ose të degëzuara, siç janë ato tipiket comedocarcinoma (78%). Në të kundërt mikrokalçifikimet të lidhuara me formën jo comedo shfaqen më shpesh në morfologjinë grandulare (53%). Këto shprehje të ndryshme janë të lidhura me modele arkitekturore (Holland e coll.) Është vërejtur që mikrokalçifikimet në grupin e comedocarcinomi ndodheshin në qendër të mbetjeve nekrotike dhe ishin amfore, ndërsa ato të lidhura me formën jo comedo, që ishin më të rralla ndodheshin në brendësi të hapësirave ndërqelitore dhe nuk ishin të lidhura me nekrozat. Duhet të rikujtojmë që mikrokalçifikimet që janë shprehje e comedocarcinoma përshkruajë nëpërmjet mamografisë me përafrimin të mirë shtrirjen e vërtetë të lezionit, në të kundërt neoplazitë jo comedo mund të rezultojnë në ekzaminim histologjik shumë të mëdha (të përhapura) sesa vetë kalçifikimet (43-46). Nga sa thamë rezulton qartë se si ektensionii DCIS është i vështirë për tu vlerësuar në aspektin radiologjik, ndërkohë ajo mund të jete e nënvlerësuar si për vështirësitë perceptuese ashtu dhe për dhe për praninë e indeve neoplastike që s'kanë precipitate gëlqerore. Prandaj është e nevojshme të kujtojmë që në studimin radiologjik të këtyre formave duhet të ndiqen disa rregulla të thjeshta metodologjike:

- Të kryhet gjithmonë një mamografi preoperative me teknikë në I.D. për një studim korrekt topografik të kalçifikimeve.

- Parapërgatit gjithmonë radiografinë e mostrës operatore sepse lejon kirurgun dhe patologun të kenë orientim korrekt në studimin e kufinjëve, në mënyrë që të sigurohet një heqje e plotë e lezionit.
- Ngul një age në të gjitha vatrën e mikrokalçifikimeve të njohura në mostrën kirurgjikale për të synuar më të mirë dhe për të lehtësuar leximin e lezioneve nga ana e patologut .
- Ti rekomandojmë pacientes një kontroll Mammografik të afërt në rastin e terapisë kirurgjikale konservative. Ajo lehtëson zbulimin e mikrokalçifikimeve të mbetura dhe i dallon nga ato që rrjedhin (lindin) nga post-radioterapia apo edhe nga përsëritje (recidivat) që mund të lindin në distancë (47-50).

Mammografia është një ndihmë e vlefshme në diagnozën e DCIS, por radiologu edhe tani nuk ka elementët për të përcaktuar diagnozën e tipit histologjik vetëm mbi bazën e studimeve të modeleve të ndryshme të kalçifikimeve.

#### Hipertrasparenca

Me hipertrasparencë kuptojmë një zonë iperdiafana e kufizuar nga një rim e hollë radiopake përgjithësisht i plotë ndonjëherë i ndërprerë. Hipertrasparencat janë forma ovale ose të rrumbullakta, me madhësi të ndryshueshme saqë nganjëherë zënë pothuajse gjithë tërësinë e gjirit. Lipoma ose pseudolipoma bashkë me liponekrozën janë shkak më i shpeshtë i këtyre imazheve.

#### Asimetria

Asimetria është prezenca e indeve të gjëndrave të një zone të përcaktuar më shumë ose më pak e zgjeruar, e shpërndarë në mënyrë asimetrike në lidhje me controlaterale. Përgjithësisht në mungesë të alterimeve patologjike, ajo është thjeshtë për shkak të diversitetit të strukturës së gjirit në lidhje me controlaterale.

#### Asimetria focale (e vatrës)

Asimetria focale është një zonë prej indeve të gjëndrave pa karakteristikat e një mase të vërtetë por megjithatë e njohur me një aspekt të ngjashëm në proiezione të ndryshme (C-C, M-L, OBL).

Edhe pse ajo mund të jetë vetëm një shprehje e një asimetrie banale të lokalizuar në parenkimë, është i përshtatshëm një studim plotësues me hollësi të drejtuar në kuptimin dhe integrimin e ekzaminimit ekografik.

#### Trashje dhe tërheqje e lëkurës

Të dyja mund jenë të shpërndara ose të lokalizuara. Sipërfaqe të lëkurës ndikohet direkt me trashësinë e plagës së shkaktuar dhe dhe nganjëherë ulçeracioni i lëkurës ose në mënyrë indirekte nëpërmjet ligamenteve të Cooper, që shfaqen nganjëherë të tërhequr. Proçeset që mund të shkaktojnë të tilla alterime janë të shumëfishta: përfshirja



neoplastikë për vazhdimësi, neoplazi primitive të lekurës, infeksione, phlogosis, stazë linfatike, plagët dhe liponekroza (51-53).

## 1.8 Strategjia diagnostikuese

Analizat e kalçifikimeve na çojnë për të shprehur një orientim diagnostikues duke i përcaktuar në:

- Beninje
- E një natyre të caktuar apo e dyshimtë; bëhet fjalë për ato kalçifikime të ashtuquajtura “borderline” në të cilat niveli i dyshimit nuk është i mjaftueshëm sa për të bërë biopsi kirurgjikale me një lerësim citologjik ose më mirë mikrohistologjik.
- Malinje

Citologjia (FNA) mund të japë një përfundim të mirë diagnostikues në studimin e kalçifikimeve të shoqëruara me patejdukshmëri, por është pak e rëndësishme në studimin e atyre të izoluar siç mund të shihet nga të dhënat e literaturës.

Vlera më të larta sensibiliteti dhe cilësië arrihen zakonisht me anë të core-biopsy dhe edhe më të mirë kohët e fundit duke përdorur age me diametër më të madh (11-14 G) me sisteme të dedikuara siç është vacum biopsy me Mammotome (54-56).

Rezultatet e sjellura deri tani në literaturë indikojnë një saktësi e shkëlqyer diagnostikuese > 99%, sidomos në rastet e mikrokalçifikimeve dhe opacita’ të vogla dhe një konkordancë histologjike mes VB e BC. Kontestimi radiografik i mostrave të marra që tregojnë praninë e kalçifikimeve bën të menjëhershëm nevojën për të konfirmuar përshtatshmërinë e mostrave.

## 1.9 Mammografia: Semiotika

Për të folur për semiotikën Mammografike do të thotë të përcaktosh cilat janë shënjat elementare që lejojnë një interpretim të saktë të studimit. Semiotika nuk mund të jetë e ndarë në të njëjtën kohë nga përdorimi i një semantike të saktë që lejon të shprehim gjykimin diagnostikues.

Proçesi interpretativ zhvillohet nëpërmjet një vazhdimësisë logjike etapat e së cilës parashikojnë:

- Kontroll të cilësisë së imazhit
- Saktësi
- Analizë
- Integrim
- Përmbajtje

Vështirësia që del në studimin Mammografik të mamelës është e lidhur me anatomicën e këtij organi, të karakterizuar nga struktura me pak ndryshim në kontrast intrinsekt të përbëra kryesisht nga indi fibroepithelial dhe ai dhjamor. Densiteti mamografik rrjedh nga mbledhja dhe shpërndarja e strukturave përbërëse të organit si dhe trashësia e saj dhe është e influencuar kryesisht nga përvetësimin i tyre i ndryshueshem, në lidhje me simujt hormonal. Përceptimi i një plagë ose i një çrregullimi strukturor mund të rezultojë i vështirë në qoftë se nuk aplikohet një metodologji korrekte e “leximit ” të ekzaminimit Mammografik që garanton një observim vijues dhe krahasues në zona të kufizuara, për secilin projektion (drejtim). (57-60).

Pas identifikimit, çdo ndryshim duhet t’i nënshtrohet një analize morfologjike dhe strukturore të detajuar dhe të klasifikuar në bazë të shenjave semjotike elementare që e karakterizojnë. Disa karakteristika të veçanta të rezultateve bëjnë të mundur që të klasifikojnë një plagë duke e drejtuar shumicën e kohës, në gjykimin diagnostikues drejt beninjes ose malinjes. Kështu përkufizohet Vlera Parashikuese Pozitive (VPP) ose më mirë të themi mundësia në përqindje, probabiliteti që një e dhënë, një shenjë ka shprehjen e një lezionit malinj.

### **1.10 Shenjat mamografike mund të ndahet në:**

Patejdukshmëri  
Shtrembërim  
Kalçifikime  
Hipertrasparaenca  
Asimetria  
Asimetria qendrore  
Trashje dhe tërheqje e lëkurës  
Edema  
Dilatacion asimetrik i duktuseve

- Patejdukshmëri

Është një lesion që zë një hapësirë të dukshme në dy projektionet; kjo nënkupton konceptin e masës dhe vëllimit, perceptohet ndryshe një ndryshim në një projektion të vetëm, duhet të përshkruhen si një densitet ose asimetri. Ajo duhet të përcaktohet në vend, formë, konturet, densitet, vëllimi, uni ose plurifocalita, uni ose multicentricity dhe në fund mono ose bilariteti.

Patejdukshmëria mund të jetë e klasifikuar si:

- e kufizuar
- yjore
- e përhapur

Patejdukshmëria (errësira) e kufizuar është më e zakonshme, ajo është morfologjikisht e përcaktuar mirë, mund të jetë e rrumbullakët, me formë ovale ose e parregullt. Kufinj të mund të shfaqen të qartë, me hije, ose të keq-përcaktuar.

Densiteti mund të jetë më i madh, më i vogël ose i njëjtë me atë të parenkimës përreth; ndonjëherë errësira mund të jetë e përzier me indin dhjamor duke i dhënë origjinë imazheve të ashtuquajtura të përziera me zona të tjera të alteruara hipertrasparente.

Një shëmbull i errësirës së kufizuar të rrumbullakët ose në formë ovale me kufinj neto është lezioni cistik që shfaqet zakonisht e orientuar në drejtimin e thithit të gjirit, sipas strukturës trabecolare të gjirit (61,62).

Karcinoma e gjirit (midollare) mund të paraqesë formë edhe kjo pak a shumë të rrumbullakët, me kufinj të keq përcaktuar ose spiculati dhe me dendesi të lartë. Parregullsitë e kufinjëve i interesojnë pjesërisht lezionit duke konfiguruar aspektin “prej komete”.

Patejdukshmëria (errësira) stelare mund të bëhen të dukshme me një bërthamë qendrore radiale pak a shumë homogjene, si cung dhe të shkurtër, me gjatësi proporcionale me bërthamën qendrore nga të cilat rrezatojnë, me aspektin “prej ylli”, ose pa bërthamë por si rezultat i striave radio-pache jo homogjene të zgjatura dhe dukshëm asimetrike të grupuar ndonjëherë në tufa dhe të alternuara në zonat iperdiafane, me aspekt “a coccarda”.

Vlerësimi i dendësisë, që mund të jetë i butë dhe johomogjen ose e rritur dhe homogjene, bashkangjitur me prezencën e kalçifikimeve intra lezionale dhe repertorit klinik, orientojnë gjykimin (vlerësimin) klinik. (63-65).

Një neoplazi infiltruese në të cilën carcinoma “scirroso” shfaq bërthamën qendrore intensivisht radiopaco prej ku shpërndahen spicule radiale të dendura, të trasha më tepër homogjene, me gjatësi proporcionale me bërthamën. Mund të jenë prezente mikrokalçifikime të çrregullta dhe shpesh në lezionet më voluminoze dhe/ose sipërfaqësore shoqërohet me një repertor klinik të dyshuar me tërheqje të lëkurës

Patejdukshmëria (errësira) e përhapur nuk është e përcaktuar mirë morfologjikisht dhe mund t'i interesojë zonave pak a shumë të zgjeruara të gjirit (67-70).

Jo gjithmonë është e mundur të përcaktohen kufinj të qartë dhe mund të rezultojë e vështirë për të bërë diferencimin në planin semiotik; një errësirë e përhapur nga një asimetri focale ose nga një rritje e dendësisë e lidhur, për shëmbull me edema të stazave; pra bëhet thelbësore evidentimi i shenjave klinike të cilat, trashja e lëkurës dhe studimi, edhe me indagimi të tjera instrumentale, të kavitetit axiliar për gjetjen e adenopative. Patologjitë që mund të manifestohen radiologjikisht me opacita të përhapur janë: mastitis bacterial; mastitis carcinomatosa dhe carcinoma multicentrike në fazë evolutive, së bashkë me fotot e edemës nga pezmatime të rënda deri te bllokimi limfatik axiliar.

- Shtrembërim parenkimal

Shtrembërimi parenkimal është shprehje e ndryshimit të orientimit normal të një zone të corpus mamme (të gjirit) drejt thithit të gjirit. Densiteti është përgjithësisht i butë dhe alterimi mund të modifikohet pjesërisht në projeksione të ndryshme. Mund të konfigurohet si një parregullsi si i profilit anterior ashtu edhe i atij posterior që mund të shfaqen të drejtë ose pa përcaktuar një masë të vërtetë, e cila përbën karakteristikën e shtrembërimit parenkimal. Kur alterimi i përket corpus mammae qëndrore, parenkima shfaqet si i fishkur, shumë për të konfiguruar një aspekt “cocardata” o “festone.” Në lidhje me paraqitjen e vendeve të shtrembërimit, nqs në korrespondencë të kufinjëve anterior ose në të kundërt të atyre posterior të corpus mammae, dallohet një shtrembërim marginal dhe një intraparenkimale (71-73).

### **1.11 Mammotome**

Suksesi i Mammografisë si metodikë ekzaminimi, është e lidhur me mundësinë për të identifikuar leziona malinje në fazën e ashtuquajtur preklinike, ose me diametër nën pragun e një centimetri. Kjo mund të sulmojë sëmundjen kur akoma nuk ka përparuar, duke favorizuar kështu pra reduktimin mortalitetin dhe terapinë kirurgjikale konservative dhe më e rëndësishmja garanton rezultate më të mira estetike dhe një cilësi më të mirë të jetës së pacientit. (74).

